



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 122 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 / 08 / 2023

VENDIM

Nr. 30, date 30 / 08 / 2023

PËR

PROJEKT IDENE E OBJEKTIT

“RIKONSTRUKSIONI I DIGES SE REZERVUARIT KUTREQ”, TIRANE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.08.2023 mori në shqyrtim Projekt Idene e paraqitur nga Bashkia Tirane për Rikonstruksionin e Diges se Rezervuarit të Kutreq e cila administrohet nga kjo Bashki. Në dokumentacionin e paraqitur nuk jepet asnjë dokumentacion në lidhje me pronësinë dhe autoritetin e shfrytëzuesit të diges. Kjo dige me lartësi 16 m dhe gjatësi të kreshtes së diges prej afro 90 m është ndërtuar në vitin 1981.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente Rebus shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se **projekt ideja e paraqitur nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit të mesipër si dhe të nenit 8 të VKM se mesipërme**. Raporti mbështetës për studimin sizmik duhet të plotësohet me autorët dhe licencat përkatëse. Raportet gjeologjike dhe gjeoteknike nuk janë të plota.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mungojnë llogaritjet hidraulike të shkarkuesit, të dhënat për matjet batimetrike, sistemet e monitorimit, vendi i karrierave për materialet e ndërtimit që do të përdoren, informacion në lidhje me njëzëzit në rrezik poshtë diges, etj

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antareve të KKDM të mos miratojnë Projekt Idene e paraqitur për shkak të mungësave të paraqitura me sipër dhe mosplotësimin të kërkesave të legjislativës në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratojnë Projekt Idene për Rikonstruksionin e Diges se Rezervuarit të Kutreq për shkak të mosplotësimin të kërkesave të legjislativës në fuqi, mungësive të konstatuara në studimet mbështetëse për çështjet e gjeologjisë dhe gjeoteknikes si dhe mungësive në lidhje me sistemet e monitorimit në dige, llogaritjet hidraulike për sistemin e shkarkimit, matjet batimetrike të rezervuarit dhe studimit për karrierat e parashikuara
- 2- Ti kërkojë Bashkisë Tirane
 - Të rishikojë studimet mbështetëse për gjeologjinë dhe gjeoteknikën e zonës në përputhje me kushtet aktuale. Të kryejë matjet batimetrike dhe të paraqesë studimin përkatës për vendet e karrierave dhe për njëzëzit në rrezik duke u bazuar në llogaritjet e vales vërsuese dhe në hartat e përmbajtjeve për zonat poshtë diges
 - Të paraqesë në projekt idene e paraqitur sistemet e nevojshme të monitorimit të diges



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te plotesoj dokumentacionin e projekt idese per rikonstruksionin e diges se Kutreqit ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi te permendura ne kete Vendim dhe te shprehet ne lidhje me domosdoshmerine, qellimin dhe efektivitetin e projektit te ri per rikonstruksionin e kesaj dige.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

